



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Ekstra 87

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 8.4.2004	3
Udhëzim i MMPAU nr. 1, datë 26.9.2012	
Për metodikën e hartimit të planeve vjetore të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie dhe procedurat e miratimit të tyre.....	4

REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, vullnetin e dyanshëm për zhvillimin e tyre të mëtejshëm në të mirë të dy vendeve dhe popujve tanë, si dhe të paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit në rajon, e të integritit europian dhe euroatlantik;

Duke mbajtur parasysh se Greqia, si vend mik, anëtar i Bashkimit Europian dhe NATO-s, përbën një partner shumë të rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë për arritjen e objektivit madhor për integrimin në strukturat euro-atlantike;

Duke konsideruar Konventën Europiane, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, të njohura nga të dyja palët;

Mbështetur në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së mirë dhe Sigurisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

- *Vlerëson* se është koha që çështja e të drejtave të shtetasve shqiptarë me origjinë çame të rimerret në shqyrtim nga të dy palët, në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit, Fqinjësisë së mirë dhe Sigurisë, të nënshkruar dhe të ratifikuar nga të dyja vendet;

- *I kërkon qeverisë së Republikës së Shqipërisë* të shtojë më tej përpjekjet për zgjidhjen e çështjes së pronave dhe pasurive të tjera të patjetërsueshme të popullsisë çame, në përputhje me dokumentet e njohura ndërkombëtare;

- *Çmon* se gjetja e një zgjidhjeje të shpejtë në aspektin teknik dhe juridik midis qeverive të dy vendeve për çështjen e sekuestros konservative të vendosur si rrjedhojë e Ligjit të Luftës të vitit 1940 mbi pasuritë e popullsisë çame, si dhe ngrirjen e ligjit nr. 2664 të 3 dhjetorit 1998, do të përbënin një kontribut shumë të rëndësishëm për kapërcimin e problemeve të krijuara prej tyre;

- *I kërkon* qeverisë shqiptare që nëpërmjet grupeve të posaçme të punës të bashkëpunojë me palën greke dhe, në frymën e Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Fqinjësisë së mirë, të përshpejtojë fillimin e negociatave me qeverinë greke për zgjidhjen e këtij problemi;

- *Shpreh* bindjen se Parlamenti i Republikës së Greqisë, i cili ushqen të njëjtin vullnet për çuarjen përpara të marrëdhënieve dypalëshe shqiptaro-greke, do të japë kontributin e tij për trajtimin me frymë konstruktive dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes së lartpërmendur, duke bërë edhe rregullimet ligjore përkatëse;

- *Ngarkon* qeverinë e Republikës së Shqipërisë që këtë Rezolutë t'ua bëjë të njohur qeverive dhe institucioneve ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në zgjidhjen e problemit.

Tiranë, më 8 prill 2004



UDHËZIM
Nr. 1, datë 26.9.2012

**PËR METODIKËN E HARTIMIT TË PLANEVE VJETORE TË PËRDORIMIT TË
LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE DHE PROCEDURAT E
MIRATIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6 të nenit 25 të ligjit nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”,

UDHËZOJ:

1. Çdo zonë gjuetie pajiset me planin vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, në të cilin paraqiten veprimet që do të ndërmerren nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë.
2. Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, hartohet sipas metodikës së paraqitur në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
3. Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, dorëzohet nga menaxhuesi i zonës në DSHP-në respektive dhe, brenda 20 ditëve nga dorëzimi i tij, miratohet nga DSHP-ja sipas procedurave të paraqitura në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen menaxhuesit e zonave të gjuetisë dhe drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe.

**MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**
Fatmir Mediu

SHTOJCA 1
**METODIKA PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PËRDORIMIT TË LLOJEVE TË
FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE**

Plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, hartuar sipas kësaj metodike, trajton çështjet kryesore të menaxhimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, duke pasur si objektiv përdorimin e qëndrueshëm të tyre, që siguron mbijetesën afatgjatë të llojeve, objekt gjuetie dhe zhvillimin e qëndrueshëm të popullatave të tyre.

Për hartimin e planit vjetor të përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie (që këtu e më poshtë, për lehtësi, do t'i quajmë “plani/planet vjetore të përdorimit”), ndiqet metodologjia e mëposhtme:

I. Përlllogaritja e përafërt për fondin e zhvillimit të faunës së egër, për kapacitetin e zonës së gjuetisë dhe për mundësinë e gjuetisë

Në mënyrë që një zonë gjuetie të jetë e vlefshme për gjueti sportive dhe turistike, në planin vjetor të përdorimit duhen pasqyruar të dhëna të përditësuara dhe të besueshme, duke filluar nga të dhënat kryesore për zonën e gjuetisë dhe duke vijuar me popullatat e çdo lloji objekt gjuetie, që është prezent në atë zonë, sikurse janë:

1. Skema, madhësia dhe planvendosja/harta skicë e zonës së gjuetisë, me një përshkrim të plotë të saj, duke u përqendruar në tipat kryesorë të habitateve që strehojnë llojet e faunës së egër (kryesisht ato objekt gjuetie) dhe gjendjen aktuale të këtyre habitateve si faktor me ndikim të drejtpërdrejtë në faunën e egër.

2. Të dhëna për llojet e faunës së egër, jo objekt gjuetie, që gjenden në zonë, veçanërisht këtu për llojet që janë pjesë e listës së kuqe të faunës.

3. Të dhëna sasiore për popullatat e llojeve të faunës së egër që gjenden në zonë dhe tipat kryesorë të habitateve, përfshirë gjendjen dhe trendin e tyre.

4. Të dhëna të hollësishme për llojet e faunës së egër, objekt gjuetie, përfshirë llojet migratore, që janë prezente në zonë dhe tendencën e popullatave të tyre 10 vitet e fundit. Këto të dhëna, si dhe ato që kërkohen në pikën 3 më sipër, do të sigurohen duke u mbështetur edhe në të dhënat e botimeve kërkimore shkencore dhe proceset e monitorimit.

5. Mbi bazën e analizave dhe të dhënave të mësipërme, llogaritet një kuotë vjeljeje vjetore prej 10 % të gjendjes aktuale dhe shtesës natyrale të popullatës për secilin prej llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, që është i pranishëm në zonë.

6. Nga numri total i llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, të identifikuar dhe të vlerësuar, llogaritet kapaciteti i zonës në terma të numrit maksimal të gjuetarëve që mund të ushtrojnë aktivitetin e gjuetisë sportive dhe turistike në zonë, duke u bazuar në kohëzgjatjen e sezonit të gjuetisë dhe ditët e lejuara për gjueti të miratuara, në sipërfaqen e përhapjes së kërkuar nga çdo lloj i faunës së egër, objekt gjuetie sipas biologjisë së llojit, si dhe duke respektuar rreptësisht kuotat ditore të vjeljes së llojeve “objekt gjuetie”.

II. Shtimi i individëve të llojeve, objekt gjuetie, ndërtimet, mbjellje bimësh e sigurim ushqimi në dobi të këtyre llojeve

7. Aktiviteti i gjuetisë sportive do të udhëhiqet nga parimi i përdorimit të qëndrueshëm të popullatave të llojeve, objekt gjuetie, duke e realizuar këtë nëpërmjet një menaxhimi afatgjatë të planifikuar të këtyre llojeve, që siguron qëndrueshmërinë e popullatave dhe mbijetesën e llojeve dhe që ka si target sigurimin e statusit të favorshëm të ruajtjes së tyre.

8. Mbi bazën e të dhënave dhe analizës së tyre sipas paragrafit I.4, bëhet identifikimi i llojeve prioritare të faunës së egër, objekt gjuetie, popullatat e të cilave kanë trend negativ zhvillimi në vitet e fundit.

9. Për secilin prej llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, të pranishëm në zonë, veçanërisht për llojet me trend negativ zhvillimi:

a) do të planifikohen masa konkrete që do të stimulojnë shtimin e numrit të popullatave të tyre, në mënyrë që të arrihet mbajtja e numrit të popullatave dhe të mos ketë rënie të tyre;

b) do të propozohen plane veprimi për to, që do të realizohen në një afat disavjeçar.

10. Masat konkrete që do ndërmerren do të konsistojnë:

a) në planifikimin e shtimit në gjendje gjysmë të lirë të këtyre llojeve dhe lëshimin e tyre në jetën e egër;

b) në ndërtime të thjeshta që lehtësojnë strehimin dhe në dobi të llojeve të faunës së egër, si p.sh. çerdhe apo mjedise për të pirë ujë, si dhe forma të tjera që mundësojnë një facilitet në kushtet e vështira të motit;

c) me sigurimin e ushqimit nëpërmjet mbjelljes së bimëve dhe llojeve të tjera të ushqimit suplementar të gatshëm për periudhën e ngricave dhe të ftohtit të dimrit etj.

11. Masat do të shoqërohen me një buxhet të planifikuar për realizimin e secilës prej tyre, si dhe një kosto totale vjetore për zonën e gjuetisë.

III. Përgatitjet në terren, ndërtimet në dobi të gjuetarëve, vendosje shenjash e mirëmbajtje shtigjesh për gjuetarët

12. Në planin vjetor të përdorimit, në përputhje me hartën, sipërfaqen dhe kufizimet e miratuara të zonës së gjuetisë, menaxhuesi i zonës së gjuetisë paraqet:

a) skicimin e saj dhe vendet në të cilat do të vendosen tabelat orientuese që japin informacion për zonën e gjuetisë;

b) kufijtë e shtrirjes së saj dhe përcaktimin;

c) kufijtë e sipërfaqeve që nuk lejohet gjuetia, nëse ka të tilla;



d) pikat hyrëse në zonë etj.

13. Çdo zonë gjuetie normalisht duhet të ketë jo më shumë se dy pika hyrëse në të (në të cilat menaxhuesi kontrollon dokumentet dhe realizon kryerjen e pagesave) dhe gjithashtu jo më shumë se dy pika të daljes.

14. Pozicionimi i pikave të hyrjes dhe të daljes bëhet në pika strategjike dominuese të zonës së gjuetisë, nëpërmjet të cilave menaxhuesi të mund të kontrollojë lëvizjet në zonë.

15. Tabelat që japin kufijtë dhe madhësinë e zonës duhet të vendosen në pozicione të dukshme dhe me ngjyra që bien në sy lehtësisht.

16. Në planin vjetor të përdorimit në kuadër të masave përgatitore, përpara fillimit të sezonit të gjuetisë, identifikohen rrugët e mundshme të kalimit të gjuetarëve në zonën e gjuetisë dhe propozohen masat konkrete, si dhe buxheti i kërkuar për mirëmbajtjen e tyre.

17. Gjithashtu, në planin vjetor të përdorimit parashikohen edhe ndërtime të thjeshta në dobi të gjuetarëve, si p.sh. pika vrojtimi të shpendëve apo ngritja e ambienteve (faciliteteve) të thjeshta për çlodhje dhe rekreacion.

SHTOJCA 2

PROCEDURAT E MIRATIMIT TË PLANIT VJETOR TË PËRDORIMIT TË LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

Përpara miratimit të tij, plani vjetor i përdorimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie (që këtu e më poshtë, për lehtësi, do ta quajmë “plani/planet vjetore të përdorimit”), do t’i nënshtrohet këshillimit të publikut.

Për miratimin e planeve vjetore të përdorimit ndiqen hapat e mëposhtme:

1. Plani vjetor i përdorimit, i hartuar sipas metodikës së paraqitur në shtojcën 1 të këtij udhëzimi, duhet të paraqesë në faqe të parë të punimit:

a) DSHP-në së cilës i adresohet;

b) emrin e zonës së gjuetisë për të cilin është hartuar;

c) kohën gjatë së cilës do të zbatohet;

d) emrin dhe firmën e hartuesit të tij – menaxhuesit të zonës së gjuetisë.

2. Plani vjetor i përdorimit përcillet zyrtarisht në DSHP-në ku bën pjesë zona e gjuetisë për të cilën ai është hartuar. DSHP-ja bën regjistrimin dhe protokollimin e praktikës (të planit vjetor të përdorimit) së ardhur dhe kopje të këtyre të dhënave (të datës dhe numrit përkatës të protokollit) ia përcjell menaxhuesit të zonës së gjuetisë.

3. Për shqyrtimin e çdo plani vjetor të përdorimit që paraqitet në DSHP, drejtori i saj krijon një komision prej jo më pak se tre personash që procedon nën drejtimin e tij, me pjesëmarrjen në këtë komision të juristit të DSHP-së, nëse ka të tillë në DSHP, si dhe duke evituar konfliktin e interesit.

4. Komisioni merr në shqyrtim secilin plan vjetor të përdorimit që paraqitet, duke verifikuar:

a) nëse ai është mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, në mënyrë të veçantë këtu, në kërkesat që parashtron neni 25 i ligjit “Për gjuetinë”;

b) nëse ai përputhet me metodikën e hartuar, paraqitur në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

5. Komisioni, nëse ka vërejtje për planin vjetor të përdorimit, i harton ato dhe DSHP-ja, brenda 7 ditëve pune nga data e dorëzimit të planit vjetor të përdorimit në protokollin e DSHP-së, ia paraqet vërejtjet menaxhuesit të zonës së gjuetisë me kërkesën për ritrajtim e ripunim të planit vjetor të përdorimit.

6. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë i shqyrton vërejtjet dhe bën përmirësimet e duhura bazuar në sa kërkohet nga DSHP-ja. Menaxhuesi dorëzon planin vjetor të përdorimit të përmirësuar në DSHP brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për ritrajtim.

7. Me marrjen e planit vjetor të përdorimit të ripunuar, komisioni përkatës në DSHP, nën drejtimin e drejtorit të saj, merr në shqyrtim planin vjetor të ripunuar dhe:

a) e miraton planin vjetor të përdorimit brenda afatit të përcaktuar në ligj;

b) në se e sheh të nevojshme që duhen dhënë detyra për t'u zbatuar, e miraton planin vjetor të përdorimit brenda afatit të përcaktuar në ligj, duke lënë me shkrim detyra për ndjekje dhe zbatim nga menaxhuesi.

8. E gjithë procedura e shqyrtimit dhe miratimit të planeve vjetore të përdorimit nga DSHP-ja protokollohet. Plani vjetor i përdorimit, i miratuar, firmoset nga drejtori i DSHP-së, vuloset dhe protokollohet në DSHP. Në rastet e pikës 7/b më sipër, planit vjetor të përdorimit të miratuar i bashkëlidhen detyrat që i lihen për ndjekje e zbatim menaxhuesit, detyra këto që gjithashtu firmosen nga drejtori i DSHP-së, vulosen dhe protokollohen së bashku me planin vjetor të përdorimit.

9. Drejtori i DSHP-së, pas kësaj, njofton menjëherë zyrtarisht menaxhuesin e zonës së gjuetisë për miratimin e planit vjetor të përdorimit dhe, në rastet kur menaxhuesit i lihen detyra për t'u ndjekur dhe zbatuar, ia përcjell zyrtarisht këto detyra.

10. Drejtori i DSHP-së njofton zyrtarisht MMPAU-në për çdo plan vjetor të përdorimit të miratuar.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 20.6.2013
Doli nga shtypi më 20.6.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 8 lekë